



FILLOJNË PAKËNAQËSITË E BRENDSHME NË LËVIZJEN VETËVENDOSJE

LIBURN ALIU JEP DORËHEQJE NGA POZITA E MINISTRIT, SHKAK ZGJEDHJA E BASHËS KRYEPARLAMENTAR

1 FAQE 4-5



Liburn Aliu ka njoftuar të mërkurën se ka dhënë dorëheqje si ministër në detyrë i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe letrën e dorëheqjes ia ka dorëzuar kryeministrit në detyrë, Albin Kurti.

Ai ka treguar se dorëheqja e tij vjen pas zgjedhjes së Dimal Bashës kryetar i Kuvendit të Kosovës, duke vlerësuar se nuk është në frymën e në lartësinë e atij ideali për Republikën që ka qenë dhe mbetet

arsye angazhimi i tij. Analistët politikë pasi kanë komentuar dorëheqjen e Aliut, kanë theksuar se Vetëvendosja do ta ketë vështirë ta ndalojë turrjen e saj në periudhën e tashme dhe të ardhshme

AKTUALE



TRUMPI E NGRE MUNDËSINË E NJË
"LUFTE EKONOMIKE" NËSE RUSIA
NUK LËVIZ DREJT PAQES F. 2

TRI DITË PARA PËRFUNDIMIT TË
AFATIT, NUMRI I VOTUESVE JASHTË
KOSOVËS ARRIN GATI NË 30 MIJË F. 6

BLERIM SALLAHU ÇAKTOHET
USHTRUES I DETYRËS SË MINISTRIT
TË DREJTËSISË F. 6

EKONOMI



OEK-u RITHEKSON KËRKESËN
PËR PEZULLIMIN E DETYRUESHËM
TË DALJES NË TREGUN
E LIRË TË ENERGJISË F. 8

AKK: MUNGESA E UJIT TË PIJES
ËSHTË PËRGJEGJËSI E QEVERISË
DHE KRU-VE, JO E KOMUNAVE F. 8

SPORT



FODA DHE SYLVINO TË PREMTEN
BËJNË PUBLIKE LISTËN
E FUTBOLLISTËVE F. 10

KUVENDI PA
FUND: PSE
KUSHTETUESJA
S'I PËRCAKTON
PASOJAT PËR
SHKELËSIT E
MUNDSHËM? F. 4



EMISARI I FRANCËS
PËR BALKANIN
PËRËNDIMOR TAKON
LIDERËT POLITIKË NË
PRISHTINË, DISKUTIMET
FOKUSOHEN PËR
ZHVILLIMET POLITIKE
DHE PROCESET
INTEGRUESE F. 5



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Trumpi e ngre mundësinë e një “luftë ekonomike” nëse Rusia nuk lëviz drejt paqes

UASHINGTON, 27 GUSHT - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, sërish e ka hedhur poshtë mundësinë e ndonjë takimi së shpejti mes udhëheqësve rusë dhe ukrainas, si dhe ka folur për mundësinë e sanksioneve të reja ndaj Moskës, megjithëse tha se edhe pala ukrainase është në faj. “Unë dua që ajo [lufta] të përfundojë”, u tha Trump gazetarëve në Shtëpinë e Bardhë. “Ajo që e kam në mendje është shumë, shumë serioze, nëse më duhet ta bëj. Por, dua ta shoh [luftën] duke përfunduar”, theksoi ai. “Ne duam përfundimin e saj. Ne kemi sanksione ekonomike”, paralajmëroi ai.

Trump shtoi: “Nuk do të jetë një luftë botërore, por do të jetë një luftë ekonomike. Një luftë ekonomike do të jetë e keqe, dhe do të jetë e keqe për Rusinë, dhe unë nuk e dua këtë”.

Ka kohë që Trump e përdor kërcënimin me sanksione ekonomike apo tarifa të larta kundër vendeve të tjera në çështje ndërkombëtare.

Ai ka paralajmëruar por ende nuk ka vendosur masa ekonomike kundër Moskës, megjithëse ShBA-ja dhe Perëndimi kanë vendosur një sërë sanksionesh të rënda ndaj Rusisë prej se ajo e filloi pushtimi e plotë të Ukrainës në shkurt të vitit 2022. “Mendoj se, në shumë mënyra, ai [presidenti rus Vladimir Putin] është aty. Ndonjëherë ai është aty dhe



[presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky nuk është aty”, nënvizoi ai. “Duhet t’i kem të dy njëkohësisht”, shtoi Trump pas një mbledhjeje të transmetuar në televizion të kabinetit, që zgjati tri orë e 16 minuta. “As Zelensky nuk është plotësisht i pafajshëm. Unë kaloj shumë mirë me të tani, por kemi marrëdhënie shumë më ndryshme sepse tani nuk po ia japim asnjë qindarkë Ukrainës”, tha Trump, duke iu referuar një marrëveshjeje ku anëtarët e NATO-s blejnë armë amerikane për t’u përdorur nga Kievit. Trump gjithashtu la të kuptohej për mundësinë e masave kundër Kievit, por nuk dha hollësi. “Unë kam marrëdhënie shumë të mira

me Putinin. Nëse mund t’i shpëtoj mijëra njerëz nga vdekja përmes sanksioneve ndaj Rusisë ose Ukrainës ose kujtdo tjetër, është mirë”, shtoi ai.

Kur u pyet për refuzimin e Putinit për t’u takuar ballë për ballë me Zelenskyn dhe për dyshimet e Kremlinin mbi “legjitimitetin” e udhëheqësit ukrainas, Trump tha: “Nuk ka rëndësi çfarë thonë [rusët]. Të gjithë po bëjnë shfaqje. Janë broçkulla”.

Rusia ka vazhduar me pushtimin e plotë të Ukrainës pa ndërprerje pas takimeve të Trumpit me Putinin në Alaskë, më 15 gusht, dhe me Zelenskyn dhe liderët evropianë në Shtëpinë e Bardhë tri ditë më vonë.

Trump, i cili që prej se e mori

detyrën në janar ka kërkuar ta ndërmjetësojë përfundimin e luftës, i përdori ato takime për ta organizuar një takim ballë për ballë mes Putinit dhe Zelenskyt, të cilët nuk janë takuar që nga viti 2019.

Zelensky, i cili ka kërkuar një takim të tillë me Putinin më 26 gusht tha se Turqia, vendet e Gjirit ose shtetet evropiane mund të shërbejnë si mikpritës të çdo takimi që ai mund të mbajë me Putinin.

Megjithatë, ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov, i tha javën e kaluar televizionit NBC se “agjenda e një takimi të tillë nuk është gati aspak”.

I dërguari special i Trumpit, Steve Witkoff, më pas tha se së shpejti

do të takohet me përfaqësuesit ukrainas në Nju Jork. “Po takohem me ukrainasit këtë javë... dhe ky është një sinjal i madh”, i tha ai Fox News. “Ne flasim me rusët çdo ditë”.

Ndërkohë, udhëheqësit ushtarakë ukrainas njoftuan Zelenskyn mbi zhvillimet në lindje të vendit, ku Rusia ka shënuar fitore në fushëbetejë muajt e fundit kundër ushtrisë së dërrmuar dhe pajisur dobët ukrainase. “Vëmendja jonë kryesore tani është e përqendruar kryesisht në Pokrovsk, Dobropillia, Novopavlivsk, Kupiansk, si dhe në drejtimet e Zaporizhjas”, shkroi në Telegram komandanti i lartë ushtarak i Ukrainës, gjenerali Oleksandr Syrskiy.

Syrskiy raportoi se “kemi prirje pozitive në zonat kufitare të rajoneve Sumi dhe Harkiv”, megjithëse pretendimet nga fushëbeteja nuk mund të verifikohen gjithmonë menjëherë.

Kievi ka kërkuar me urgjencë më shumë armë nga Perëndimi mes shqetësimeve se, edhe pas dy samiteve të fundit në Shtetet e Bashkuara, Rusia “nuk është e interesuar” për paqe, tha një këshilltar i lartë i Zelenskyt për Current Time, më 25 gusht.

Shtetet e Bashkuara dhe vendet evropiane i kanë dhënë Ukrainës ndihmë dhe pajisje ushtarake me vlerë miliarda dollarë që nga fillimi i pushtimit të plotë, megjithatë Trump i ka bërë trysni Evropës ta marrë përsipër pjesën më të madhe të barrës.

Inspektorët bërthamorë kthehen në Iran, por rivendosja e sanksioneve duket e pashmangshme

TEHERAN, 27 GUSHT - Gati dy muaj pasi Teherani ndërpreu bashkëpunimin me Agjencinë Ndërkombëtare për Energjinë Atomike (IAEA), mbikëqyrësi bërthamor i OKB-së ka dërguar sërish inspektorë në Iran, pikërisht në kohën kur vendi po përballlet me mundësinë e rikthimit të sanksioneve të mëdha ndërkombëtare. Irani i pezulloi inspektimet në korrik, duke cituar bombardimet amerikane dhe izraelite ndaj objekteve kyç në qershor. Por, rikthimi i inspektorëve është kryesisht simbolik.

Tani për tani, misioni i IAEA-së - i konfirmuar nga drejtori i përgjithshëm Rafael Grossi, ka karakter përgatitor dhe përqendrohet në “modalitetet praktike” për rikthimin e vëzhgimit në disa objekte të shpërndara, disa prej të cilave u dëmtuan rëndë nga sulmet.

Pa qasje dhe bashkëpunim më të madh, është e pamundur të shtyhet rikthimi i sanksioneve të OKB-së, të cilat fuqitë evropiane synojnë t’i rikthejnë në fund të muajit.

Edhe nëse Irani lejon vizitat në disa objekte, hyrja në lokacione të ndjeshme si Fordo, Natanz dhe Isfahan - të gjitha të goditura nga bombardimet amerikane mund të mbetet e ndaluar, gjë që kufizon aftësinë e IAEA-së për ta verifikuar veprimtarinë bërthamore të Iranit.

Një pengesë edhe më e madhe është rezerva e uraniumit të pasuruar e Iranit. Rreth 400 kilogramë uranium i pasuruar pranë nivelit për armë mbetet i zbuluar, duke ngritur alarm në kryeqytetet perëndimore.

Treshja evropiane Britania e Madhe, Franca dhe Gjermania e kanë bërë të qartë se lehtësimi i sanksioneve varet nga tri kushte:

rikthimi i plotë i inspektimeve, raportimi transparent i rezervave të uraniumit dhe angazhimi i besueshëm në diplomaci me Uashingtonin.

Këtë të fundit, Irani e ka kundërshtuar në mënyrë të përsëritur, përfshirë edhe fundjavën e kaluar, duke mos dashur të zhvillojë bisedime të drejtpërdrejta me Shtetet e Bashkuara.

Behnam Taleblu, drejtor i lartë i programit për Iranin në Fondacionin për Mbrojtjen e Demokracive me bazë në Uashington, i tha Radios Farda të “Radios Evropa e Lirë” se është “shumë e pamundur” që evropianët ta shtyjnë rikthimin e sanksioneve. “E vetmja mënyrë që kjo të ndodhë është nëse inspektorët rifillojnë plotësisht vëzhgimin dhe nëse ka vullnet real politik në Teheran për diplomaci. Në atë rast, sanksionet mund të shtyheshin



për tre deri në gjashtë muaj... Por, e shoh shumë të pamundur”, tha ai.

Gjendjen e përkeqëson edhe mosbesimi i thellë i Iranit ndaj IAEA-së, të cilën e akuzon për anshmëri politike dhe për dështim në dënimin e

veprimeve ushtarake të Izraelit dhe ShBA-së.

Media të linjës së ashpër kanë shkruar edhe më larg. Gazeta Kayhan madje ka bërë thirrje që Grossi të “gjykohej dhe të ekzekutohej”, nëse shkel në tokën Iran.

FILLOJNË PAKËNAQËSITË E BRENDSHME NË LËVIZJEN VETËVENDOSJE

LIBURN ALIU JEP DORËHEQJE NGA POZITA E MINISTRIT, SHKAK ZGJEDHJA E BASHËS KRYEPARLAMENTAR



Liburn Aliu ka njoftuar të mërkurën se ka dhënë dorëheqje si ministër në detyrë i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe letrën e dorëheqjes ia ka dorëzuar kryeministrit në detyrë, Albin Kurti. Ai ka treguar se dorëheqja e tij vjen pas zgjedhjes së Dimal Bashës kryetar i Kuvendit të Kosovës, duke vlerësuar se nuk është në frymën e në lartësinë e atij ideali për Republikën që ka qenë dhe mbetet arsye angazhimi i tij. Analistët politikë pasi kanë komentuar dorëheqjen e Aliut, kanë theksuar se Vetëvendosja do ta ketë vështirë ta ndalojë tkurrjen e saj në periudhën e tashme dhe të ardhshme

kundrejt atyre që i konsideron kundërshtarë. Në të paktën pesë postime gjatë gushtit, ai e ka përdorur fjalën “langarecët” për t'i kritikuar opozitën, sistemin e drejtësisë, por edhe mediet.

Muharremi: Vetëvendosja do ta ketë vështirë ta ndalojë tkurrjen e saj në periudhën e tashme dhe të ardhshme

Analisti politik, Shenoll Muharremi, ka reaguar pas dorëheqjes së Liburn Aliut nga posti i ministrit në detyrë të Infrastrukturës, duke e cilësuar këtë zhvillim si tregues të krizës së brendshme në Lëvizjen Vetëvendosje dhe rënies së saj, siç thotë ai, në “kurthin e lakmisë për pushtet absolut”. “Dorëheqja e Liburn Aliut po demonstroi që LV-ja dhe Albin Kurti kanë rënë në kurthin e lakmisë për pushtet absolut dhe kanë humbur rrugën. Një parti që dikur fliste për demokraci dhe ideale sot është shndërruar në makineri autokratike, pa frymë të brendshme demokratike, pa konsultime cilësore të brendshme dhe pa busull morale. LV-ja ka braktisur gjithçka për çka u formua”, ka shkruar Muharremi në “Facebook”.

Ai ka thënë se partia e Albin Kurtit sot merret me kapjen e bordeve e institucioneve publike, me vendosjen e militantëve në çdo cep të shtetit, me ndërhyrje brutale politike në RTK dhe institucione tjera. “E madje edhe me sulme ndaj ekonomisë dhe bizneseve që e ushqejnë këtë shtet”, ka thënë ai. Muharremi ka theksuar se Liburn Aliu nuk është i pari e as i fundit që e ka lënë Kurtin. “Shumica e njerëzve me integritet, vlera dhe shkathtësi janë larguar. Aty kanë mbetur kryesisht ata që nuk guxojnë ta sfidojnë liderin edhe kur ai gabon, duke mos i dhënë asnjë vlerë as partisë, as shoqërisë. Sot LV-ja është e njohur si parti e përçarjes dhe polarizimit, e linçimeve, sulmeve, nacionalizmit negativ dhe populizmit të rrezikshëm. Parti e mosbashkëpunimit dhe bllokadës institucionale”, është shprehur ai. Shenoll Muharremi ka thënë se dështimi për të krijuar frymë të brendshme të pluralizmit dhe demokracisë ka prodhuar një parti pa kapacitete për qeverisje dhe pa vizion për të ardhmen. Sipas tij, e ardhmja e LV-së nuk duket e mirë pa një reformë të thellë dhe të gjerë. “E partia do të ketë vështirë ta ndalojë tkurrjen e saj në periudhën e tashme dhe të ardhshme. Rruga që ka zgjedhur lideri dhe po aplikon partia

duket sikur rrugë drejt humbjes dhe tkurrjes sistematike derisa vjen një moment që reforma dhe ndryshimet janë e vetmja rrugë për shpëtim”, ka deklaruar Muharremi.

Ramadani: Zërat e pakënaqur brenda LV-së do të rriten

Edhe njohësi i çështjeve politike, Burim Ramadani, ka reaguar pas dorëheqjes së Liburn Aliut nga pozita e ministrit të Mjedisit. Ramadani ka shkruar në “Facebook” se zërat e pakënaqur brenda LV-së do të rriten vazhdimisht, ndërkaq sipas tij, nuk do të ketë as Qeveri Kurti 3. “Zërat e pakënaqur brenda LV-së do të rriten vazhdimisht në publik, janë të shumtë! Ndërrimi i kandidatit ishte zgjidhja që u dëshmuar e patjetërsueshme. Sidoqoftë, bllokada disa-mujore u tejkallua në pjesën kryesore nga ndërrimi i kandidatit. Me zgjedhjen e kryeparlamentarit të ri, Dimal Basha, Kosova tash është afër tejkallimit të plotë të ngërçit institucional e politik. Hapi i fundit rreth tejkallimit të plotë të bllokadës duhet të ndodh nesër, jo më larg. Qeveria Kurti 3 nuk do të bëhet. Të gjitha këto ngjarje të këtyre muajve janë dëshmitë finale pse nuk ka dhe nuk duhet të ketë Qeveri Kurti 3”, ka thënë Ramadani.

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 27 GUSHT - Liburn Aliu ka njoftuar të mërkurën se ka dhënë dorëheqje si ministër në detyrë në Qeverinë e Kosovës, për shkak të, siç tha, zgjedhjes së Dimal Bashës në postin e kryetarit të Kuvendit të Kosovës një ditë më parë. “Dua t’ju njoftoj që sapo e dorëzova te kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, letrën e dorëheqjes sime nga detyra e Ministrit në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës”, shkroi Aliu në “Facebook”. Ai shpjegoi se dorëheqja e tij vjen pasi dje bashkëpartiaku i tij, Dimal Basha, u zgjodh kryetar i

Kuvendit të Kosovës.

Aliu tregoi se e kishte njoftuar kryeministrin në detyrë, Albin Kurti, për vendimin e tij menjëherë pas zgjedhjes së Bashës të martën. “Konsideroj që zgjedhja e djeshme e Kryetarit të Kuvendit, institucionit më të lartë, ku vendosen ligjet dhe jep llogari qeveria, nuk është në frymën e në lartësinë e atij ideali për Republikën që ka qenë dhe mbetet arsye angazhimi për mua”, tha Aliu. Aliu, i cili është anëtar dhe ndër themeluesit e Lëvizjes Vetëvendosje nuk mori pjesë në zgjedhjet e fundit parlamentare, të mbajtura më 9 shkurt. Dimal Basha që u zgjodh kryetar Kuvendi me 73 vota për, njihet për gjuhën e tij të vrazhdë



KUVENDI PA FUND: PSE KUSHTETUESJA S'I PËRCAKTON PASOJAT PËR SHKELËSIT E MUNDSHËM?

Prishtinë, 27 gusht- Kur dukej se Kuvendi i Kosovës po shkonte drejt konstituimit, procesi u bllokua te zgjedhja e nënkryetarit nga komuniteti serb.

Përpyekja e radhës për ta përmbyllur këtë proces është caktuar për 28 gusht - në ditën e dhjetë të afatit 30-ditor të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese për konstituimin e Kuvendit.

Por, çfarë ndodh nëse ky afat nuk respektohet - e gjasat janë, nëse konfirmohen “shkeljet” që i kanë potencuar disa ekspertë gjatë zgjedhjes së katër prej pesë nënkryetarëve?

Gjykata Kushtetuese nuk e ka sqaruar këtë dhe as nuk ka dhënë përgjigje në pyetjet me shkrim të “Radios Evropa e Lirë” lidhur me arsyet pse nuk ka përcaktuar pasoja për shkelësit e mundshëm. Një skenar i ngjashëm është shpërfaqur edhe më 26 qershor, kur Kushtetuesja ka lëshuar një aktgjykim po për këtë çështje, pa i caktuar sanksionet, e që gjithashtu nuk është respektuar.

Ruajtja e standardit dhe mirëbesimit

Ehat Miftaraj, drejtor i Institutit të Kosovës për Drejtësi, thotë se Gjykata Kushtetuese ka shmangur qëllimisht përcaktimin e pasojave të moszbatimit në vendimet e fundit, për të ruajtur standardin e

vitit 2014, sipas të cilit partia fituese ka të drejtën e propozimit të kryetarit të Kuvendit. “Kushtetuesja ka tentuar ta ruajë këtë standard si në qershor, ashtu edhe në gusht”, thotë Miftaraj për “Radion Evropa e Lirë”. Sipas tij, ky institucion ka vepruar parimisht drejt, duke mos i paragjykuar deputetët e Kuvendit dhe partitë politike për zbatimin ose moszbatimin e vendimit të tij. “Gjykata nisat gjithmonë nga fakti që vendimet e saj, Kushtetuta, zbatohen në mirëbesim dhe jo në bazë të inateve personale, partiake e të tjera”, thotë Miftaraj. Megjithatë, sipas tij, Kushtetuesja është dashur të vendoste një masë ndëshkuese ndaj kryesuesit të seancës konstituive, Avni Dehari, i cili kishte devijuar rendin e ditës, duke kërkuar krijimin e një komisioni për votim të fshehtë të kryetarit të Kuvendit, në kundërshtim me vendimin e Gjykatës.

“Ndrojtja” e Kushtetueses nga politika

Mungesën e një sanksioni ndaj Deharit e ka theksuar edhe ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani, në një intervistë për “Radion Evropa e Lirë” më 24 gusht. Ai ka thënë se gjykata e ka shmangur qëllimisht përcaktimin e pasojave, duke u mbështetur në

Pse nuk u finalizua konstituimi i Kuvendit?

Më shumë se gjysmë viti pas zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit, deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Dimal Basha, u zgjodh kryetar i Kuvendit të Kosovës më 26 gusht.

Po të njëjtën ditë u zgjodhën edhe tre nënkryetarët nga partitë shqiptare dhe një nga pakicat joserbe, ndërsa konstituimi ngeci te zgjedhja e nënkryetarit serb.

Procesi u zhargit me muaj për shkak të mosmarrëveshjeve politike dhe devijimeve nga

rendi i ditës, dhe përfundoi në Gjykatën Kushtetuese nga disa deputetë opozitarë të legjislaturës së kaluar.

Më 26 qershor, Gjykata urdhëroi Kuvendin të konstituohej brenda 30 ditësh, por afati u injorua.

Më 24 korrik, Kushtetuesja ndaloi mbajtjen e seancës konstituive pas skadimit të afatit, ndërsa më 8 gusht urdhëroi zgjedhjen e kryeparlamentarit përmes votimit të hapur. Aktgjykimi u publikua më 18 gusht, duke nisur një afat të ri.

mirëbesimin e deputetëve dhe duke vepruar, siç është shprehur, “me një lloj ndrojtjeje”. “Arsyeja përse Gjykata nuk po i vë në dukje pasojat juridike-kushtetuese për individët që në mënyrë specifike pengojnë dhe rrënojnë procesin e konstituimit të Kuvendit të Kosovës, lidhet - nga njëra anë - me frikën nga politika dhe reagimet e saj irracionale”, ka thënë Hasani, duke përmendur në mënyrë specifike fituesen e zgjedhjeve, Lëvizjen Vetëvendosje, dhe “brutalitetin me të cilin ajo ka ftuar për linç ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese”.

Në të njëjtën linjë me Hasanin, analisti Artan Muhaxhiri vlerëson

se Gjykata Kushtetuese ka qenë nën presion të madh, sidomos para aktgjykimit të 26 qershorit - çka ka prodhuar vendime të paqarta dhe të hapura për interpretime të ndryshme nga partitë dhe opinionin publik. Sipas tij, Gjykata e ka shmangur përcaktimin e masave ndaj shkelësve për shkak të “ndrojtjes nga presionet publike e jopublike”, sidomos nga Lëvizja Vetëvendosje. “Ajo (LV) e ka një qasje tashmë shumë të qartë: kur Gjykata Kushtetuese jep një aktgjykim që i shkon në favor, e lëvdon atë. Kur jep një aktgjykim që nuk i shkon në favor, e linçon dhe i prezanton edhe emrat që e kanë marrë atë

vendim. Pra, është një presion i hatashëm”, thotë Muhaxhiri për “Radion Evropa e Lirë”.

Vetëvendosje e ka cilësuar vendimin e fundit të Kushtetueses si “arbitrar”, ndonëse udhëheqësi i saj, Albin Kurti, ka premtuar se do të respektojë çdo vendim.

Pa u publikuar aktgjykimi i plotë, por pasi është shpallur nga Kushtetuesja më 8 gusht, deputeti i Vetëvendosjes, Sali Zyba, ka publikuar emrat e gjykatësve të Kushtetueses, duke thënë se “duan t’ia marrin të drejtën LV-së për të propozuar kryetarin e Kuvendit”.

Një postim të ngjashëm në “Facebook” e ka bërë edhe Dejana Mihali, koordinatore e komiteteve në Lëvizjen Vetëvendosje.

Miftaraj dhe Muhaxhiri theksojnë se, nëse Kuvendi dështon të konstituhet plotësisht deri më 18 shtator, deputetë ose parti politike mund t’i drejtohen Kushtetueses për qartësimin e pasojave juridike - gjë që do ta detyronte Gjykatën t’i përcaktonte hapat për tejkalimin e ngërçit institucional.

Edhe Hasani ka paralajmëruar se gjykata mund të vihet në lëvizje nëse afati 30-ditor nuk respektohet.

Kërkesë të ngjashme ka bërë më herët presidentja Vjosa Osmani, por e ka tërhequr atë, për shkak se si raportues për shqyrtimin e kërkesës së saj është caktuar gjykatësi Radomir Llaban, të cilin ajo e konsideron “rrezik për sigurinë kombëtare”.

EMISARI I FRANCËS PËR BALLKANIN PERËNDIMOR TAKON LIDERËT POLITIKË NË PRISHTINË, DISKUTIMET FOKUSOHEN PËR ZHVILLIMET POLITIKE DHE PROCESET INTEGRUESE

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 GUSHT - Emisari i Francës për Ballkanin Perëndimor, Rene Troccaz, ka takuar të mërkurën liderët e partive politike në Kosovë.

Ai është takuar me kryetarin e PDK-së, Memli Krasniqi, me të cilin ka diskutuar për zhvillimet në vend dhe proceset integruese. “Sot, pata kënaqësinë të pres në takim emisarin francez për Ballkanin Perëndimor, Rene Troccaz. E falënderova për vëmendjen që Franca i kushton Kosovës dhe rajonit tonë, sidomos në këto kohë sfidash globale. E ritheksa se rruga më e drejtë dhe më e shpejtë për të

mbyllur kapitullin e Ballkanit Perëndimor është integrimi sa më i shpejtë i vendeve tona në Bashkimin Evropian. Biseduam për zhvillimet e fundit politike në Kosovë dhe për nevojën që vendi ynë të ecë përpara, me institucione funksionale dhe me dialog konstruktiv. Në këtë drejtim, e njoftova emisarin Troccaz që si PDK, ne kemi dhënë kontributin tonë, si përgjegjësi politike, por edhe si vetëdije institucionale, duke votuar kryetarin e Kuvendit në funksion të zhbllokimit të situatës”, ka thënë Krasniqi, cili e ka falënderuar edhe ambasadorin Guerot dhe të gjithë zyrtarët francezë në Kosovë për mbështetjen e

vazhdueshme ndaj shtetit tonë. “PDK-ja mbetet e përkushtuar për stabilitet, përgjegjësi institucionale dhe të ardhmen evropiane të Kosovës”, ka shkruar Krasniqi në “Facebebook”.

Të dërguarin e posaçëm të Francës për Ballkanin Perëndimor, Rene Troccaz, si dhe ambasadorin e Francës në Kosovë, Olivier Guerot, i ka pritur edhe kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku.

“Gjatë bisedës sonë diskutuam mbi zhvillimet e fundit politike në vend dhe situatën aktuale, veçanërisht sfidat me të cilat po përballon Kosova - nga bllokada institucionale deri te pasojat e qeverisjes populiste - si dhe

qëndrimet e LDK-së karshi kësaj gjendjeje. Theksua qartë se Lidhja Demokratike e Kosovës nuk mbështet praktika që dëmtojnë funksionimin kushtetues dhe normalitetin institucional të vendit. Ata që e kanë nisur këtë rrugëtim, duhet të marrin përgjegjësinë për krizat që i shkaktojnë me vetëdije”, ka thënë Abdixhiku, duke theksuar se në fund ka shprehur mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme që Franca i ka dhënë Kosovës në të gjitha proceset e saj shtetformuese dhe për rolin e rëndësishëm të saj në mbështetjen e integritimit evropian të vendit tonë.

Edhe lideri i AKK-së, Ramush Haradinaj, ka pritur në takim

emisarin e Francës për Ballkanin Perëndimor.

Ai ka thënë se Franca ka luajtur rol të rëndësishëm në përpjekjet e popullit të Kosovës për liri, pavarësi dhe shtetndërtim, dhe gjithashtu partnere e rëndësishme e vendit tonë në shumë fusha. “Në takim me z. René Troccaz, i dërguar special i Francës për Ballkanin Perëndimor, zhvilluam diskutim përmbajtësor lidhur me proceset në të cilat po kalon Kosova, si dhe për zhvillimet politike e të sigurisë në vend dhe në rajon. Mirënjohës për angazhimin e z. Troccaz dhe për përkushtimin e shtetit francez ndaj Kosovës”, ka shkruar Haradinaj.



Edhe pse Osmani e ka tërhequr kërkesën, Hasani ka thënë se Kushtetuesja ka të drejtë ta vazhdojë procedurën.

Pas zgjedhjes së Bashës kryekuvendar, Osmani ka shfaqur shpresën që konstituimi i Kuvendit të përmbyllet sa më parë, në përputhje me Kushtetutën.

Megjithatë, çështja mund të vazhdojë të zvarritet, pasi disa njohës të zhvillimeve politike konsiderojnë se procesi i zgjedhjes së nënkryetarëve ka qenë jokushtetues.

Sipas tyre, votimi për nënkryetarët nga komunitetet pakicë nuk mund të ndahet, siç ka ndodhur

në seancën e 26 gushtit. “Aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese kanë përcaktuar se konstituimi i Kuvendit duhet të bëhet edhe në bazë të praktikave të deritanishme, sipas të cilave pesë nënkryetarët e Kuvendit janë votuar në dy pako të ndara”, është thënë në reagimin e Institutit

Demokratik të Kosovës.

Edhe Albert Krasniqi nga organizata Demokraci Plus ka thënë se procedura për zgjedhjen e dy nënkryetarëve që përfaqësojnë komunitetet joshumicë duhet të përsëritet, pasi mënyra e ndjekur nuk ka qenë në përputhje me

Kushtetutën.

“Zgjedhja e tyre duhet të bëhet me një votim të vetëm, në bllok, për të dy kandidatët”, ka thënë ai.

Kjo është hera e parë që seanca konstituive e Kuvendit të Kosovës zhvillohet me 58 vazhdimë pa u përmbyllur. Përpjekja e 59-të është caktuar për 28 gusht.

Tri ditë para përfundimit të afatit, numri i votuesve jashtë Kosovës arrin gati në 30 mijë

PRISHTINË, 27 GUSHT - Kanë mbetur tri ditë deri në përfundim të afatit për aplikimin e votuesve me postë, për zgjedhjet lokale që do të mbahen më 12 tetor. Sipas zëdhënësit të Komisionit Qendrorë të Kosovës (KQZ), Valmir Elezi, nga data 23 korrik deri më 27 gusht, ora 09:00, përmes platformës elektronike <https://diaspora.kqz-ks.org>, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka pranuar gjithsej 35,381 aplikime për regjistrim për votim me postë. Në shumicën e rasteve të

refuzuara, aplikuesit nuk kanë paraqitur njërin nga dokumentet që dëshmon adresën e tij jashtë Kosovës (dokument identifikues në të cilin është e shënuar adresa e banimit, vërtetim i adresës nga autoriteti lokal, kontratë të qirasë, faturë shërbimesh, dokument i lëshuar nga banka apo kompania e sigurimit, dokument që dëshmon adresën e personit tek i cili qëndrojnë përkohësisht, dëshmi tjetër banimi për rastet specifike (rezervim hoteli, konvikti, etj.

Komunat me mbi 1 apo 2 mijë shtetas të regjistruar për votim me postë nga jashtë Kosovës janë: Gjakova (2,204), Suhareka (2,129), Dragashi (2,045), Prizreni (1,775), Deçani (1,659), Klina (1,643), Istogu (1,538), Vitia (1,291), Gjilani (1,256), Peja (1,193), Malisheva (1,145), Rahoveci (1,111) dhe Juniku (1,000). Gjermania (13,336) dhe Zvicra (7,132) janë shtetas të Kosovës të regjistruar për votim me postë nga jashtë vendit.



SORENSEN THEKSON RËNDËSINË E NORMALIZIMIT TË RAPORTEVE KOSOVË - SERBI

PRISHTINË, 27 GUSHT - I dërguari i Bashkimit Evropian për dialogun, Peter Sorensen, pas përfundimit të takimeve me liderët shtetëror në Beograd, ka bërë të ditur se gjatë takimeve ka theksuar rëndësinë e normalizimit të raporteve me Kosovën për të mirën e njerëzve. “Pas vizitës sime në Prishtinë në fillim të gushtit, sot isha në Beograd për bisedime përgatitore para takimeve të ardhshme të Dialogut. I dëgjova me kujdes bashkëbiseduesit e mi dhe theksova rëndësinë e normalizimit për të mirën e njerëzve në terren”, ka shkruar ai në platformën sociale “X”. Ndryshe Vuçiq pas takimit me Sorensen tha se biseda ishte e hapur dhe u fokusua në vazhdimin e dialogut nën ndërmjetësimin e BE-së, si dhe në sfidat që lidhen me pozitën e serbëve në Kosovë.

Vuçiq theksoi se “dialogu duhet të kthehet te parimet themelore, veçanërisht te detyrimi për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe dhe mbrojtja e të drejtave të qytetarëve serbë në Kosovë”. Ai kritikoi përpjekjet për të ndaluar pjesëmarrjen e Listës Serbe në zgjedhjet e ardhshme, duke i cilësuar si rrezik për respektimin e të drejtave themelore dhe lirinë politike të serbëve në Kosovë. “Politika jonë është politikë paqeje, e përkushtuar në kërkimin e zgjidhjeve kompromisi përmes dialogut, por edhe në mbrojtjen e interesave shtetërore e kombëtare”, ka deklaruar ai. Sipas Vuçiqit, stabiliteti rajonal mund të arrihet vetëm përmes respektit të ndërsjellë, përgjegjësisë dhe zbatimit të plotë të marrëveshjeve ekzistuese.



KOSOVË - MAQEDONI E VERIUT PAJTOHEN PËR AVANCIMIN E PRAKTIKAVE NË FUSHËN E PSIKIATRISË FORENZIKE



PRISHTINË, 27 GUSHT - Institucioni i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës (IPFK) ka mirëpritur një delegacion nga Spitali Psikiatrik Forenzik - Shkup, në kuadër të një vizite zyrtare me qëllim të shkëmbimit të përvojave profesionale dhe forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e psikiatrisë forenzike. Delegacioni nga Shkupi, i përbërë nga Isa Avdullai drejtor, si dhe përfaqësues të tjerë nga Spitali Psikiatrik Forenzik, u prit nga stafi drejtues dhe profesional i IPFK-së dhe pati

mundësinë të vizitë nga afër të katër repartet e institucionit. Gjatë takimit, drejtori i IPFK-së, Shpend Haxhibeqiri, prezantoi punën dhe funksionimin e institucionit, duke vënë theksin tek proceset menaxhuese, arritjet, sfidat dhe standardet e punës në institucion. Ai theksoi rëndësinë e trajtimit profesional dhe etik të pacientëve brenda sistemit të drejtësisë dhe shëndetit mendor. Delegacioni zhvilloi takime të ndara edhe me shefat e reparteve, ku u prezantuan protokollet e trajtimit dhe menaxhimit të

pacientëve me nevoja psikiatrike forenzike. Po ashtu, kryeinfermieri i IPFK-së, Qemajl Krasniqi, prezantoi organizimin e stafit infermior dhe ofrimin e kujdesit shëndetësor për pacientët, me theks të veçantë në edukimin e vazhdueshëm profesional në këtë fushë të specializuar. Kjo vizitë pasqyroi angazhimin e përbashkët të të dy institucioneve për ngritjen e cilësisë së shërbimeve dhe avancimin e mëtejshëm të praktikave në fushën e psikiatrisë forenzike në nivel rajonal.

Blerim Sallahu caktohet ushtrues i detyrës së ministrit të Drejtësisë

Prishtinë, 27 gusht - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka caktuar të mërkurën zëvendësministrin e

deritanishëm të Drejtësisë, Blerim Sallahu, ushtrues të detyrës së ministrit të Drejtësisë, pas zgjedhjes së

Albulena Haxhiut në pozitën e nënkryetares së Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kryeministri Kurti e uroi

Sallahu për përgjegjësinë e re dhe i dëshiron suksese në përmbushjen e detyrave, ka njoftuar Zyra e Kryeministrit.



Uran Ismaili zotohet për 100 autobusë të rinj dhe zhblokim të trafikut për 18 muaj në Prishtinë

PRISHTINË, 27 GUSHT - Kandidati i PDK-së për kryetar të Prishtinës, Uran Ismaili, ka folur për gjendjen e rënduar të transportit publik në kryeqytet, duke theksuar se që nga viti 2016 nuk është blerë asnjë autobus i ri. Ai tha se shumë lagje të Prishtinës nuk mbulohen fare nga linjat urbane, ndërsa aty ku kalojnë autobusët mungojnë stacionet dhe pritoret. Qytetarët shprehen të pakënaqur me vonesat dhe

menaxhimin e dobët komunal. “Është problem te puna e autobusëve, për arsye se nuk e ke kurrë të sigurt kohën e arritjes, menaxhimi nuk është i duhur në këtë aspekt”, tha një qytetare. Një banor nga Kodra e Trimave shtoi: “Atje nuk kemi as stacion, as kurgjë, hiç. Na kanë lënë komplet. Është tmerr”. Përballë kësaj situate, Ismaili ka shpalosur zgjidhjen e tij për tejkalimin e këtij problemi, duke paraqitur planin për

transformimin e trafikut urban në kryeqytet: Shtim i 100 autobusëve të rinj për të mbuluar të gjitha lagjet; Krijimi i korsive të dedikuara për autobusë, ku mundësohet qarkullimi çdo 7 minuta; Renovim i stacioneve me ulëse, ndriçim dhe tabela dixhitale informuese dhe Transport publik falas për të gjithë qytetarët deri në fund të mandatit. “Është koha për një trafik urban që funksionon për të gjithë. Është koha për Prishtinën”, përfundoi Ismaili.



LV-JA ANKOHET NË SUPREME KUNDËR URDHRIT TË PZAP-it PËR CERTIFIKIMIN E LISTËS SERBE PËR ZGJEDHJE

PRISHTINË, 27 GUSHT - Anëtarë të Lëvizjes Vetëvendosje (LV) kanë bërë ankesë të martën në Gjykatën Supreme ndaj vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrim (PZAP) për ta urdhëruar Komisionin Qendror Zgjedhor (KQZ) ta certifikojë Listën Serbe për pjesëmarrje në zgjedhjet lokale. PZAP-ja e urdhëroi javën e kaluar komisionin zgjedhor ta certifikojë partinë më të madhe të serbëve në Kosovë, e cila gëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar - pak ditë pasi asaj iu mohua regjistrimi për pjesëmarrje në zgjedhjet e 12 tetorit. Dy anëtarët e LV-së në KQZ, Sami Kurteshi dhe Alban Krasniqi - të vetmit që votuan kundër certifikimit të kësaj partie - i kërkuar të martën Gjykatës Supreme ta rrëzojë vendimin e PZAP-së, konfirmuan për “Radion Evropa e Lirë” nga LV-ja. Ky rast është pothuajse një përsëritje e rastit të zgjedhjeve të përgjithshme të shkurtit, kur LV e kishte kundërshtuar deri në Supreme pjesëmarrjen e Listës Serbe në zgjedhje, por pa sukses. Vendimi për moscertifikimin e Listës Serbe është kritikuar nga vendet e QUINT-it dhe Bashkimi Evropian, të cilat i bënë thirrje



Qeverisë në detyrë dhe partive politike të mos ndërmarrin ndonjë hap tjetër për ta penguar regjistrimin e Listës Serbe për zgjedhjet e tetorit.

Pse s'u certifikua Lista Serbe?

Zyra e Partive Politike në KQZ - që ka për detyrë shqyrtimin e aplikimeve të partive politike për t'u certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje - rekomandoi certifikimin e Listës Serbe.

Megjithatë, Sami Kurteshi dhe Alban Krasniqi, ishin të zëshëm kundër certifikimit të saj, duke argumentuar se shumica e kandidatëve të saj janë pjesë edhe e strukturave paralele serbe, por e cilësuan këtë parti edhe si “dorë e zgjatur” e presidentit serb, Aleksandar Vuçiq, në Kosovë. Kurteshi tha se “90 për qind të personave që janë në listat e kandidatëve të Listës Serbe janë të anëtarësuar në institucione paralele serbe në Kosovë”. Ai e kundërshtoi kandidaturën e

Sasha Millosheviqit për kryetar të Novobërdës duke thënë se ai ishte emëruar nga Qeveria serbe për kryetar të komunës së Gjilanit, komunë kjo paralele serbe. Millosheviq ishte emëruar për kryetar të Gjilanit nga Qeveria serbe më 27 shkurt 2020, si “kryetar i Organit të Përkohshëm të Komunës së Gjilanit”. Por, Qeveria e Serbisë, më 7 gusht, mori mbi 20 vendime kadrovike për emërimin dhe shkarkimin e zyrtarëve të institucioneve, mes tyre edhe

disa që kanë qenë në krye të organeve të përkohshme për komunat në Kosovë. Këto pretendime u kundërshtuan nga Lista Serbe dhe nga Beogradi zyrtar. Ministri i Jashtëm serb, Marko Gjurij tha se ky vendim ishte “shembull flagrant i inxhinierisë politike që synon përjashtimin e popullit serb nga jeta demokratike”. Vetëvendosje luftoi kundër certifikimit të Listës Serbe edhe për zgjedhjet parlamentare të shkurtit, dhe komisioni zgjedhor nuk e kishte certifikuar atë fillimisht edhe asokohe. Megjithatë, pas ankesave në instanca më të larta, Lista Serbe u certifikua dhe mori pjesë në zgjedhje, duke i fituar 9 ulëse në Kuvend. Lista Serbe vendosi të garojë në zgjedhjet e sivjetshme lokale, pasi kishte bojkotuar zgjedhjet e kaluara lokale, duke bërë që kryetarët shqiptarë ta merrnin dhe mbanin pushtetin në katër komunat me shumicë serbe në veri të vendit nga maji i vitit 2023. Nëse certifikohet, Lista Serbe pritet t'i rimarrë të gjitha katër komunat veriore: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok.

Qendra e Studentëve gati për studentët që nisin e vazhdojnë rrugën akademike në UP

PRISHTINË, 27 GUSHT - Udhëheqësit e disa drejtorive të Qendrës së Studentëve, bashkë me drejtorin e përgjithshëm të saj, erdhën në Rektorat për të njoftuar menaxhmentin e UP-së rreth përgatitjeve të pranimit të studentëve në konvikte dhe mensë, në prag të fillimit të vitit akademik 2025/'26. Rektori i Universitetit të Prishtinës, prof. Arben Hajrullahu, bashkë me prorektorin për buxhet, financa dhe bashkëpunim me sektorin publik e privat, prof. Albana Berisha-Qehaja, pritën drejtorin e përgjithshëm të Qendrës së

Studentëve, Ekrem Rudarin, drejtorin e strehimit, kulturës dhe sportit, Isak Behën, dhe drejtorin e kuzhinës dhe restaurantit, Fahri Osmanin. Rektori Hajrullahu u dëshiroi mysafirëve të tij një vit të mbarë, të suksesshëm e pa probleme gjatë strehimit dhe përgatitjes së ushqimit për studentët, ndërsa zyrtarët e lartë të Qendrës së Studentëve treguan se gjithçka është gati për t'i pritur sa më mirë ata e ato që studiojnë në UP, ushqehen në mensë, strehohen në konvikte e përgatiten për provime në hapësirat e kësaj qendre.

Në takim u fol edhe për koordinim mes Qendrës së Studentëve dhe Rektoratit të Universitetit të Prishtinës për të mundësuar që edhe studentët e pranuar në konkursin plotësues në shtator të kenë mundësinë e shfrytëzimit të mensës dhe konvikteve. Për dallim nga vitet tjera, kur mësimi në UP fillonte më 1 tetor të çdo viti, me statutin aktual të miratuar në vitin 2024, viti akademik nis më 15 shtator. Qendra e Studentëve çdo vit pranon rreth 4000 studentë në hapësirat e saj të strehimit, studimit dhe ushqimit.



Shumë biznese të birrarisë po përballen me falimentim në Gjermani

BERLIN, 27 GUSHT - Industria tradicionale e birrës në Gjermani, një nga shtyllat kulturore dhe ekonomike të vendit, po kalon një nga periudhat më të vështira në dekada. Stefan Blaschak, drejtori ekzekutiv i birrarisë së njohur Oettinger, ka ngritur alarmin për një valë të falimentimeve që po përfshin sektorin, duke paralajmëruar se situata është më serioze se kurrë më parë. “Kjo është një krizë që nuk ka të krahassuar. Bota e birrës po

shembet”, tha Blaschak në një deklaratë për mediat dhe shtoi se: “po shohim biznese të vogla që po falimentojnë pothuajse çdo ditë. Nëse kjo prirje vazhdon, edhe birraritë e mëdha nuk do të shpëtojnë nga pasojat”. Sipas të dhënave të fundit, konsumi i birrës në Gjermani ka pësuar një rënie të ndjeshme gjatë vitit 2025, me një ulje prej 7-7.5 për qind në krahasim me vitin e kaluar. Kjo rënie vjen si vazhdim i një tendence disavjeçare, por shifrat e këtij viti

janë veçanërisht alarmante për industrinë. Në dy vitet e fundit, janë mbyllur plot 52 birrari në të gjithë vendin - shifër kjo që përbën numrin më të lartë të mbylljeve brenda një periudhe kaq të shkurtër në më shumë se 30 vjet. Kjo tregon jo vetëm për vështirësitë ekonomike me të cilat po përballen prodhuesit, por edhe për një ndryshim të thellë në zakonet e konsumatorëve gjermanë. Faktorët që kanë çuar në këtë situatë janë të shumtë:

ndryshimet në stilin e jetesës, rritja e ndërgjegjësimit për shëndetin, konkurrenca nga pije të tjera si vera dhe pijet e gazuara, si dhe rritja e kostove të prodhimit për shkak të inflacionit dhe krizave të furnizimit pas pandemisë dhe konflikteve ndërkombëtare. Blaschak thekson se nëse nuk merren masa të menjëhershme për të mbështetur industrinë, një pjesë e madhe e trashëgimisë kulturore dhe kulinare të Gjermanisë është në rrezik të zhdukët. “Birra nuk



është thjesht një produkt - ajo është pjesë e identitetit tonë kombëtar. Nëse e lejojmë këtë industri të shkatërrohet, humbasim më shumë sesa thjesht disa marka birre - humbasim një pjesë të historisë sonë,” përfundoi ai.

OEK-u RITHEKSON KËRKESËN PËR PEZULLIMIN E DETYRUESHËM TË DALJES NË TREGUN E LIRË TË ENERGJISË

PRISHTINË, 27 GUSHT - Oda Ekonomike e Kosovës së bashku me Shoqatën e Prodhuesve të Kosovës në kuadër të saj, shprehin shqetësimin e thellë lidhur me faturat e energjisë elektrike të muajve të fundit, të cilat po shndërrohen në një barrë të papërballueshme për sektorin prodhues. Në reagimin e tyre thuhet se “që nga dita e parë, Oda Ekonomike e Kosovës së bashku me Shoqatën e saj Prodhuese, ka ngritur zërin publikisht dhe institucionalisht se dalja e detyrueshme e prodhuesve në tregun e lirë do të rezultojë me çmime të papërballueshme për bizneset. Sot, fatkeqësisht, po vërtetohet pikërisht ajo për të cilën kemi paralajmëruar”. Tutje thuhet se sipas të dhënave zyrtare: Bizneset prodhuese të obliguara të furnizohen në tregun e lirë kanë paguar 162 €/MWh në qershor 2025 dhe 203 €/MWh në korrik 2025. Në të njëjtën periudhë, konsumatorët në furnizim të rregulluar kanë paguar vetëm 65-75 €/MWh. “Ky dallim i pajustificuar, mbi 3 herë më i lartë për prodhuesit, ka sjellë pasojë të rënda për konkurrueshmërinë e fabrikave



tona dhe i ka vendosur prodhuesit kosovarë në pozitë të pabarabartë në raport me sektorët e tjerë të brendshëm dhe konkurrentët rajonalë”, thuhet në reagim. Më tej, pohohet se në kulmin e verës, kur normalisht pritet ulje e çmimeve, faturat e prodhuesve janë rritur në nivele rekord. “Kjo

ngre alarmin se në periudhën e dimrit, kur konsumi dyfishohet, çmimet mund të kalojnë edhe 300 €/MWh, duke shkaktuar pasojë të pariparueshme si: mbyllje të fabrikave, humbje të mijëra vendeve të punës, rrëzim të prodhimit vendor dhe rritje të varësisë nga importet”, vazhdon reagimi.

Për këto arsye, Oda Ekonomike e Kosovës me Shoqatën e saj të Prodhuesve të Kosovës ritheksojnë me ngulm kërkesën për pezullimin e menjëhershëm të daljes së detyrueshme në tregun e lirë. “Ky është hapi i vetëm i drejtë dhe i domosdoshëm për të mbrojtur prodhimin vendor dhe për të

shmangur një krizë ekonomike të shkaktuar nga faturat e energjisë. Energjia elektrike nuk është thjesht një produkt tregu, është faktori themelor për mbijetesën e industrisë vendore. Pa ndërhyrje të shpejtë, rrezikohet seriozisht baza prodhuese dhe e ardhmja ekonomike e vendit”.

AKK: Mungesa e ujit të pijes është përgjegjësi e Qeverisë dhe KRU-ve, jo e komunave

PRISHTINË, 27 GUSHT - Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) ka shprehur shqetësim për mungesën e ujit të pijes nëpër komuna, duke thënë se kjo është përgjegjësi e Qeverisë dhe kompanive rajonale. Kështu ka thënë për “Telegrafin” kryetari i AKK-së, Sazan Ibrahim. Ai ka thënë se gjatë kësaj vere janë vërejtur shumë shqetësime të shprehura nga qytetarët te kryetarët e komunave për mungesën e ujit

të pijes në disa zona të vendit. “Është e padrejtë që komunat të fajësohen për mungesën e ujit të pijes, kurse përgjegjësia ligjore i takon kompanive rajonale dhe qeverisë. Komunat kanë bërë investime në rrjet, por pa investime qendrore në burime të reja dhe digë akumuluese nuk mund të ketë edhe përmirësim të situatës”, ka thënë Ibrahim. Ibrahim tutje ka theksuar se të gjitha pagesat për ujin e pijes dhe shërbimet e kanalizimit mbledhen nga kompanitë

rajonale të ujësjellësit, dhe jo nga komunat. “Për këtë arsye, çdo mungesë e furnizimit apo problem në cilësinë e shërbimit është përgjegjësi ligjore dhe institucionale e KRU-ve dhe e qeverisë qendrore, jo e komunave”, shtoi Ibrahim. Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës ka sqaruar edhe kompetencat që kanë komunat karshi kësaj çështje. “Komunat e Kosovës, sipas ligjit, kanë përgjegjësi vetëm për ndërtimin e

infrastrukturës së rrjetit të ujësjellësit. Pas përfundimit të investimeve, kjo infrastrukturë i kalon automatikisht në pronësi dhe menaxhim kompanive rajonale të ujësjellësit (KRU), të cilat janë nën mbikëqyrjen e Qeverisë së Kosovës”, u shpreh Ibrahim. Ibrahim ka theksuar se është shqetësuese mungesa e investimeve strategjike në gjetjen e burimeve të reja të ujit të pijes. “Është shqetësuese që nuk ka investime serioze në gjetjen e burimeve të reja të ujit



të pijes dhe në ndërtimin e digave akumuluese. Pa projekte madhore në këtë drejtim, nuk do të mund të ketë edhe përmirësim të situatës”, ka deklaruar Ibrahim.

TENSIONE DIPLOMATIKE DANIMARKË-SHBA, KOPENHAGENI AKUZON TRUMPIN PËR "OPERACIONE SEKRETE" NË GROENLANDË

Ministria e Jashtme daneze ka thirrur të ngarkuarin me punë të SHBA-së, diplomatin më të lartë në ambasadën amerikane në Kopenhagen, pasi një raportim televiziv publik raportoi "përpyqje për të ndërhyrë" në Groenlandë, një territor autonom i mbretërisë skandinave.

Sipas transmetuesit publik DR, të paktën tre amerikanë të lidhur me Donald Trump po kryejnë operacione ndikimi në Groenlandë.

"Çdo përpyqje për të ndërhyrë në punët e brendshme të Mbretërisë sigurisht që nuk do të jetë e pranueshme", tha ministri i Jashtëm danez Lars Lokke Rasmussen në një deklaratë dërguar AFP-së.

"I kam kërkuar Ministrisë së Jashtme të ftojë të ngarkuarin me punë amerikan në një takim në ministri", shtoi ai.

Sakaq, Presidenti i SHBA-së, Donald Trump, ka thënë se dëshiron që SHBA-të bëjnë pjesë të tyre ishullin strategjik në Arktik, që është i pasur me minerale për arsye të sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare,



dhe nuk e ka përjashtuar përdorimin e forcës për ta bërë këtë.

Pas zgjedhjes së tij, Presidenti

Trump shpjegoi se ai "ka nevojë" për Grenlandën, kryesisht për sigurinë e SHBA-së, dhe e ka përsëritur dëshirën e tij shumë

herë.

Groenlanda ishte përgjigjur se nuk ishte në shitje dhe se po vendoste vetë për të ardhmen e

saj. Në fund të marsit, zëvendës-presidenti i SHBA-së J.D. Vance shkaktoi trazira duke planifikuar të vizitonte ishullin e madh Arktik pa u ftuar atje. Përballë kritikave në Groenlandë, Danimarkë dhe Evropë, zëvendës-presidenti i SHBA-së e kufizoi udhëtimin e tij në bazën ajrore amerikane në Pitufik.

"Ne e dimë që aktorët e huaj vazhdojnë të tregojnë interes për Groenlandën dhe pozicionin e saj brenda Mbretërisë së Danimarkës", vuri në dukje sot edhe Ministri i Jashtëm danez.

"Prandaj nuk është për t'u habitur të shohim përpyqje të jashtme për të ndikuar në të ardhmen e Mbretërisë në të ardhmen e afërt", theksoi Rasmussen.

Që në pranverë, shërbimet daneze të inteligjencës kishin shprehur shqetësime në lidhje me "ndikimin" e mundshëm të jashtëm, kryesisht rus, veçanërisht gjatë zgjedhjeve parlamentare në Groenlandë, por përfundimisht nuk u zbulua asnjë përfshirje. (A2)

GJERMANIA REFORMON USHTRINË: RUSIA MBETET RREZIKU MË I MADH PËR SIGURINË NË EUROPË

Për herë të parë pas më shumë se tre dekadash, rikthimi i qeverisë gjermane nga pushimet verore do të bëhet në Ministrinë e Mbrojtjes. Dhe nuk është rastësi: Friedrich Merz ka vendosur që mbledhja e parë e kabinetit të tij të jetë një homazh për Bundeswehr-in dhe për reformën që do të miratohet sot. Një riorganizim i trupave gjermane që synon një objektiv ambicioz: forcimin e ushtrisë duke garantuar në të ardhmen një minimum prej 260 mijë ushtarësh aktivë dhe 200 mijë rezervistësh.

Aktualisht Bundeswehr ka 181.984 ushtarë. Polemikë e shpërthyer brenda shumicës, që ka gjasa të reflektohen edhe në diskutimin në Parlament, lidhen me mënyrat për të arritur këtë rezultat. Ministri i Mbrojtjes, socialdemokrati Boris Pistorius, kërkon ta arrijë shifrën e 260 mijë ushtarëve përmes një rekrutimi, për momentin, vullnetar. Për këtë flitet prej më shumë se tre vitesh, që nga nisja e luftës në Ukrainë, kur ish-kancelari Scholz shpalli Zeitenwende, kthesën epokale në strategjitë e Gjermanisë, dikur e konsideruar si "xhind" ushtarak. Por kthesa ka vonuar dhe tani reforma e Bundeswehr-it mbërrin në tryezën e qeverisë e shoqëruar nga debate të mëdha mes CDU-së dhe SPD-së.



Ditët e fundit, Ministria e Jashtme e drejtuar nga kristiandemokrati Johann Wadephul e kishte bllokuar. Për shefin e diplomacisë, sistemi vullnetar i reformës nuk mund të garantojë kurrë ardhjen e 80 mijë ushtarëve shtesë. Duhet një mekanizëm më detyrues. Në prag të

mbledhjes së sotme, Wadephul hoqi veton, edhe sepse kancelari dëshiron ta shohë reformën të miratuar. Dje Merz mohoi se ka përçarje në koalicion dhe theksoi se "jemi të gjithë dakord për nevojën që të shtohet ndjeshëm numri i ushtarëve". Por dyshimet brenda

konservatorëve nuk janë fashitur.

Keep Watching
Recently Spotted Asteroid Set for Near Miss With Earth
00:00/01:31

SPD e Pistorius kundërshton kthimin e detyrueshëm të shërbimit ushtarak të shfuqizuar në vitin 2011. Dhe

ligji që do të diskutohet sot nga qeveria parashikon një rekrutim të detyrueshëm në raste të jashtëzakonshme, dhe me miratim paraprak nga Bundestag-u dhe Bundesrat-i. Në preambulën e reformës shkruhet se "Rusia mbetet rreziku më i madh për sigurinë në Europë dhe po krijon ushtarakisht kushtet, si në aspektin e personelit, ashtu edhe material, për të qenë në gjendje të sulmojë territore të NATO-s".

Në planet e qeverisë, të gjithë gjermanëve të lindur pas 1 janarit 2008 do t'u dërgohet vitin e ardhshëm një formular për të përcaktuar përshtatshmërinë. Për gratë rekrutimi do të mbetet rreptësisht vullnetar. Për burrat, megjithatë, përshtatshmëria mund të shndërrohet në detyrim për t'u bashkuar ushtrisë, nëse rrethanat e jashtme do të përkeqësohen. Dhe në rast emergjence, do të merren edhe listat e të lindurve para 2008-ës. Por Pistorius është i bindur se mund të shmangë rikthimin e shërbimit të detyrueshëm – të cilin lideri i CSU, Markus Soeder, e ka quajtur të dielën e kaluar "të pashmangshëm" – sepse mendon se do të mund të shtojë numrin e ushtarëve që nga viti 2026 me 20 mijë dhe deri në vitin 2030 me 38 mijë rekrutë të rinj. (La Repubblica)



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Foda dhe Sylvino të premten bëjnë publike listën e futbollistëve

PRISHTINË, 27 GUSHT - Sikurse selektori i Kosovës, Franco Foda ashtu edhe përzgjedhësi i Kombëtares së Shqipërisë, Sylvinho do ta bëjë publike listën të premten. Tashmë është përcaktuar programi i Kombëtares shqiptare për grumbullimin e muajit shtator, ku kuqezinjtë do t'i kenë dy ndeshje, miqësoren ndaj Gjibraltarit dhe duelin kualifikues për

Botërorin 2026 kundër Letonisë. Shpallja e listës së lojtarëve të ftuar nga Sylvinho do të bëhen të premten, ndërsa në të njëjtën ditë, në orën 11:00, do të mbahet edhe konferenca për shtyp e selektorit të Shqipërisë. Shqipëria grumbullimin për ndeshjet e muajit të ardhshëm, e nis zyrtarisht më datën 1 shtator. Shqipëria më 4 shtator në stadiumin "Europa Point" do

të ketë miqësoren ndaj Gjibraltarit që nis në orën 18:00. Ndërsa, përballja Shqipëri – Letoni, që i takon kualifikimeve për Botërorin 2026, do të zhvillohet në stadiumin "Air Albania" në Tiranë më 9 shtator prej orës 20:45. Ndërsa më 8 shtator, Kosova do të luaj kundër Suedisë. Kjo ndeshje do të zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri" duke filluar nga ora 20:45.



ZHEGROVA MERR PASAPORTË SHQIPTARE, AFROHET TRANSFERIMI TE JUVENTUSI

TIRANË, 27 GUSHT - Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, me dekret ia ka dhënë nënshtetësinë shqiptare futbollistit të Kosovës, Edon Zhegrova. Sulmuesi anësor i Kosovës dhe i Lilles është duke u raportuar me medie po kërkon kalimin te Juventusit në Serinë A, por statusi i tij si ekstrakomunitar mund të jetë një pengesë. Në të tilla kushte, Zhegrova nuk do jetë më një "i huaj" në futbollin italian dhe kalimi i tij te "Zonja e Vjetër" mund të jetë më i lehtë. Ai mund të transferohet te Juventusit, falë rregullit që është miratuar në

Serinë A. Aty, çdo skuadër ka të drejtë të regjistrojë me ekipin e parë një futbollist shqiptar si komunitar. Dhe Zhegrova do të përfitojë nga ky rregull, për të kryer transferimin e tij te Juventusit, nëse të gjitha negociatat shkojnë në rrugën e duhur. "Në mbështetje të nenit 92, shkronjës 'c', nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, 'për shtetësinë', i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm, dekretoj: Dhënie e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit: 1. Edon Lulzim Zhegrova", është thënë



në dekretin e nënshkruar nga Begaj më 22 gusht. Zhegrova është raportuar me

medie se po kërkon që Lille të bindet nga oferta e Juventusit dhe këtë verë të kalojë në Serie

A. Francezët e duan në ekip, por Edoni ka bërë këtë kërkesë për të qenë një "lojtar vendas".

PESË SHQIPTARË FTOHEN TE MAQEDONIA E VERIUT, DEBUTON RAMADANI

SHKUP, 27 GUSHT - Trajneri i Maqedonisë së Veriut, Blagoja Milevski shpalosi listën e futbollistëve për dy ndeshjet e muajit shtator. Ai ka thënë se ndeshja miqësore me Arabinë Saudite dhe ndeshja kualifikuese kundër Lihtenshtajnit, duhet të japin një pamje fillestare të formës së lojtarëve në sezonin e ri. "Fatkeqësisht, nuk mund të mbështetemi te Agon Elezi për shkak të një dëmtimi në shpatull. Shpresoj se nuk do të ketë nevojë për ndërhyrje kirurgjikale. Gjithashtu, Manev dhe Ashkovski nuk janë në listë, gjë që nuk do të thotë se nuk do



të thirren në merkaton e ardhshme. Do ta përdorim ndeshjen me Arabinë Saudite për të kontrolluar se çfarë kemi

si potencial, për ata lojtarë që nuk kanë shumë kohë loje në ekipin kombëtar. Planifikojmë të provojmë disa variante

taktike, disa lojtarë do të luajnë në pozicione të panatyrshme për ta. Do të shohim nëse do të japë fryte dhe sa pozitive do të sjellin këto ndryshime. Ndeshja e dytë është ndoshta më e rëndësishme për ne në këtë cikël kualifikues. E respektojmë kundërshtarin në maksimum, po përgatitemi seriozisht dhe shpresoj që djemtë të jenë në lartësinë e detyrës, siç kanë qenë deri më tani. Kjo ndeshje mund të jetë një pikë kthese në pritje të sfidave të tetorit", ka thënë Milevski. Lista e Milevskit përfshin edhe dy debutues, Reshat Ramadanin dhe Elmin Rastoderin. "Reshat

Ramadani me performancat e tij në skenën ndërkombëtare me Shkendijën, e ka merituar plotësisht këtë thirrje. Ne kemi nevojë për një lloj të tillë lojtari në ekipin kombëtar, por varet prej tij se sa do të imponohet dhe sa i dobishëm do të jetë. Ai do të ketë një shans për të provuar se sa i përgatitur do të jetë taktikisht, fizikisht dhe mendërisht. Sa i përket Rastoder, shpresoj që me të do të fitojmë cilësi në sulm. Ai luajti shkëlqyeshëm këtë sezon në Thun dhe performancat e tij në kampionatin e fundit nuk ishin më pak cilësore", ka thënë trajneri Milevski.

Përformoi shkëlqyeshëm, Vojvoda në formacionin e javës në Serie A

ROMË, 27 GUSHT - Mbrojtësi i Kombëtares së Kosovës, Mërgim Vojvoda, ka pasur paraqitje fenomenale në fundjavë, në fitoren 2-0 të

Comos ndaj Lazios. 30-vjeçari ka pasur 4 goditje në total, 2 prej tyre në portë, 10 prekje të topit në zonën kundërshtare, 2 driblime të

suksesshme nga 3 tentime dhe ka kompletuar 35 pasime nga 41 sa ka provuar. Vojvoda është vlerësuar me notën

maksimale nga faqja "Whoscored.com". Mbrojtësi dardan është transferuar te Como në janar nga Torino për 2.5 milionë euro.



Sevilla dhe Udinese në garë për Bajramin

TIRANË, 26 GUSHT - E ardhmja e Nedim Bajramit në Skoci mbetet e paqartë. Mesfushori i kombëtares shqiptare nuk ka arritur të bindë plotësisht te Rangers dhe së fundmi është lënë jashtë listës së skuadrës, duke nxitur zërat për një largim të mundshëm në këtë

merkato. Sipas raportimeve të “Transferfeed” në Britani, për 25-vjeçarin ka interes serioz nga Sevilla në La Liga dhe Udinese në Serie A. Klubi skocez mund të pranojë ta shesë lojtarin nëse mbërrin një ofertë mes 4 dhe 5 milionë eurove, shumë që do t’i lejonte

të rikuperonin investimin e bërë verën e kaluar, kur Bajrami u transferua për rreth 4 milionë euro. Mesfushori shqiptar ka kontratë me Rangers deri në maj 2028, ndërsa sipas “Transfermarkt”, vlera e tij aktuale në treg vlerësohet rreth 3 milionë

euro. Një rikthim në Serie A, ku Bajrami ka shkëlqyer më parë me fanellat e Empolit dhe Sassuolos, ose një aventurë e re në La Liga, mund të jenë skenarët më të mundshëm për të ardhmen e një prej asistimeve më të rëndësishme të mesfushës së Shqipërisë.



Agjenti i Xhakës: Ja pse Graniti e la Leverkusenin dhe u transferua në Sunderland

SUNDERLAND, 26 GUSHT - Kur Granit Xhaka i habiti shumë njerëz duke shkëmbyer kampionët e Bundesligës, Bayer Leverkusen, me Sunderlandin e sapongjitur në Ligën Premier këtë verë, në të gjithë Evropën u ngritën vetullat në befasi. Si mundet një nga mesfushorët më me përvojë të Evropës, i sapoardhur nga gara për trofe në Gjermani, të shkëmbejë futbollin e Ligës së Kampionëve për një betejë të mundshme për rënie nga kategoria në Angli? Për të gjetur përgjigjet, faqja “Flashscore” foli ekskluzivisht me agjentin e Xhakës, Jose Noguera, i cili hodhi dritë mbi motivet pas këtij transferimi dhe vizionin që e bindi klientin e tij të merrte përsipër një nga sfidat më të guximshme të karrierës së tij.

Cfarë e shtyu Xhakën të vendoste të largohej nga Bayer Leverkusen pas një periudhe të suksesshme?
Noguera: Pas dy vitesh, Xhakës i duhej një sfidë e re. Kjo ishte bindja e tij.

Si e bindi Sunderland atë, cila ishte propozimi i tyre?
Noguera: Biseda e parë ishte në telefon me pronarin, Kyril Louis-Dreyfus, i cili është gjithashtu nga Zvicra dhe shumë i ri. Xhaka u lidh shumë mirë me Louis-Dreyfus dhe e pëlqeu vizionin që iu prezantua.

Në çfarë pike dëgjoi Xhaka për interesin e Sunderlandit dhe sa shpejt lëvizën gjërat pas kësaj?
Noguera: Kyril Louis-Dreyfus e telefonoi Xhakën drejtpërdrejt dhe e pyeti nëse do të ishte i interesuar të fillonte projektin e Sunderlandit me të. Xhaka më pas e referoi tek unë, agjenti i tij, dhe më pas filluan diskutimet.

A kishte interes nga klubet e Ligës Premier ose të Ligës së Kampionëve për nënshkrimin e Xhakës?
Noguera: Xhaka kishte shumë



interes nga klubet e Ligës Premier dhe Ligës së Kampionëve dhe refuzoi tre oferta të mëdha për t’u bashkuar me Sunderland këtë verë.

Sa rëndësi pati projekti dhe ambiciet e ardhshme të Sunderlandit në vendimin e tij?
Noguera: Xhaka zakonisht luan në klube ku bëhet fjalë për Ligën e Kampionëve, tituj lige, finale kupash etj. Megjithatë, ai donte të provonte diçka të re sepse dëshiron të bëhet trajner në të ardhmen. Kështu që ai e sheh këtë si një përvojë të re për të mësuar.

Cfarë roli luajti familja e Xhakës

në vendimin e tij për t’u bashkuar me Sunderlandin?
Noguera: Familja e Xhakës luajti një rol shumë të madh që ai të bashkohej me Sunderlandin. Pasi gruaja dhe tre fëmijët e tij ishin të gatshëm të bënin transferimin me të, ai pranoi sepse familja e tij është shumë e rëndësishme për të.

Si e sheh ai Ligën Premier krahasuar me Bundesligën?
Noguera: Futbolli në Angli luhet në një nivel shumë të lartë. Ka më shumë të bëjë me fizikalitetin dhe ndoshta më pak me aspektin teknik. Shumë lojtarë të mëdhenj vijnë në Angli dhe e kuptojnë se duhet të përmirësojnë nivelin e tyre dhe shpesh u duhet kohë për t’u përshtatur.

SHKURT

Roger Federer bëhet miliarder

Legjenda e tenisit, Roger Federer, është futur në listën e sportistëve miliarderë, duke u bërë i shtati në histori që arrin këtë status. 44-vjeçari u tërhoq nga tenisi në vitin 2022 pas një karriere të shkëlqyer, ku fitoi 130 milionë dollarë nga çmimet në fushë. Pjesa më e madhe e pasurisë së tij vjen nga marrëveshjet me sponsorë si Uniqlo, Rolex, Mercedes-Benz dhe investime të suksesshme, përfshirë markën sportive On, ku zotëron 3% të aksioneve. Pasuria neto e Federerit sipas Forbes kap vlerën e 1.1 miliardë dollarëve. Ai bashkohet me emra si Michael Jordan, LeBron James dhe Tiger Woods në elitën e sportistëve me pasuri mbi një miliard.

David pasi debutoi me gol te Juventus: E prisja një start të tillë

Juventusit e nisi sezonin e ri në Serie A me këmbën e mbarë, duke mposhtur Parmën (2-0). Një nga protagonistët e suksesit bardhezi ishte Jonathan David, i cili nuk humbi kohë për të lënë gjurmë në aventurën e tij të re, duke shënuar golin e parë me fanellën e “Zonjës së Vjetër” në debutim. “Gjëja më e rëndësishme janë tre pikët, por jam i lumtur që arrita të shënoj në ndeshjen time të parë. Tifozët na mbështetën pa pushim dhe kisha shpresuar për një start të tillë”, u shpreh sulmuesi kanadez pas ndeshjes. David gjithashtu ka shprehur dëshirën për të dhënë maksimumin gjatë gjithë sezonit: “Qëllimi im është të ndihmoj ekipin, si në mbrojtje ashtu edhe në sulm, dhe të jap gjithmonë më të mirën. Shpresoj të vazhdojmë në këtë rrugë dhe të arrijmë sa më shumë fitore”.

Vardy është synim i Cremoneses

Cremonese po ëndërron të sjellë në Serie A sulmuesin anglez Jamie Vardy. Ky nuk është vetëm një transferim fantazie, por ideja më e fundit nga skuadra e Davide Nicola-s për të forcuar sulmin. Orët e fundit është bërë kontakti fillestar midis palëve, me ish-kapitenin e Leicester, me shpresën se do të pranojë një transferim në Itali. Klubi po ëndërron shumë, duke shpresuar të tejkalojë konkurrencën dhe t’i japë trajnerit Nicola një sulmues që ka shënuar më shumë se 200 gola në karrierë. Pas fitores së tyre debutuese në Serie A, në “San Siro” kundër Milanit, ekipi i Cremoneses nuk dëshiron të ndalojë së ëndërruari. Ata po kërkojnë një sulmues dhe e kanë identifikuar sulmuesin anglez si një zgjidhje të mundshme, të preferuarin e tyre aktual. Një lojtar i lirë pas rënies së Leicester nga kategoria, Vardy shënoi 10 gola dhe dha 4 asistime sezonin e kaluar. Tani, në moshën 38-vjeçar, ai është duke kërkuar një sfidë të re dhe Cremona mund të jetë shtëpia e tij e re.

Hollywood do të përgatisë një film për Kobe Bryant

Kompania e njohur kinematografike “Warner Bros”, ka blerë të drejtat për skenarin e një filmi, që tregon historinë se si ylli i Lakersave, Kobe Bryant, u refuzua nga New Jersey Nets dhe përfundoi në Los Angeles. Një film për karrierën e Kobe Bryant do të ishte afërsisht sa

gjatësia e filmit “Lufta dhe Paqja”. Madje ndoshta gjashtë orë e tridhjetë minuta nuk do të ishin të mjaftueshme. Kjo është arsyeja pse “Warner Bros” ka siguruar skenarin për një film që do të përqendrohet ekskluzivisht në ditën e draftit të Bryant. Titulli i përkohshëm është

“Me Zgjedhjen e 8-të”. Zgjedhja e tetë në atë draft ishte në pronësi të New Jersey Nets, të trajnuar nga John Calipari. Ekipi, i cili më vonë u zhvendos në Brooklyn, dukej i vendosur të nënshkruante me Kobe, por menaxheri i përgjithshëm John Nash u “nda” nga

trajneri, i cili preferoi të përqendrohej te Kerry Kittles. Kështu, djali i Jellybean përfundoi në Charlotte me zgjedhjen e 13-të, e cila më pas e shkëmbeu atë me Lakers në këmbim të Vlade Divac. Marrëdhënia e Bryant me kinemanë ishte e fortë edhe para vdekjes së tij

tragjike. Ai fitoi një Oscar për “Dear Basketball”, një film i shkurtër i animuar për tërheqjen e tij nga basketbolli, të cilin ai e shkroi dhe e rrëfeu. Kobe, i cili vdiq kur helikopteri i tij u rrëzua në kodrat pranë Los Angeles më 26 janar 2020, do të mbushte 47-vjeç më 23 gusht.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Agro Invent” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 70457698 si dhe me nr. Unik Identifikues: 810535297 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Agro Invent” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 70457698 -UI 810535297 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavlivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Agro Invent” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 70457698 UI 810535297 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**NJOFTIM MBI ZVOGËLIMIN E KAPITALIT
TË SHOQËRISË**
" Capital Alliance Investment Advisory" L.L.C.

Në përputhje me kërkesat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare në Kosovë dhe të Marreveshjes dhe Statutit se Shoqërisë, të plotësuar dhe ndryshuara, Kuvendi i Aksionareve të shoqërisë “Capital Alliance Investment Advisory” L.L.C., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me numër unik identifikues 811300607 (“Shoqëria”) ka nxjerr:

VENDIM PËR ZVOGËLIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË me datë 27.08..2025

Kapitali i shoqërisë zvogëlohet nga nga vlera e regjistruar **1,554,387.62 Euro në 61,850.00 Euro**

Të gjithë Kreditorët e Shoqërisë kanë të drejtën që në afatin 21 ditor nga dita e publikimit të këtij njoftimi në shtypin ditor ti drejtohen Shoqërisë me kërkesë për siguri shtesë ose kërkesë për mos-zvogëlim të kapitalit. Kërkesat i drejtohen Shoqërisë përmes postës së rregullt në adresën:

“Capital Alliance Investment Advisory” L.L.C., me seli në Prishtinë, Rr. Anton Çetta nr.23



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- “Trizone Electric” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330477283.

- Enver Bajraktari shpall te pavlefshme diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

- Valin Shigjeqi shpall te pavlefshme diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

- Sabrije Ramadani shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “ Ilimi Bajraktari “ Blac.

- Fisnik Hoxhaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu “ Abdyl Frasheri “ Prizren.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me

1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

